

LIGJ
Nr.7702, datë 22.4.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7583, DATË 13.7.1992 "PËR KOMPETENCAT PËR
CAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS"**

Në mbështetje të nenint 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, rrethet, bashkitë dhe komunat ushtrojnë kontroll mbi rritjen e pagës mesatare mujore në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore të vartësisë së tyre.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore deri në 5 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave në shkallë vendi, nuk zbatohet asnjë sanksion.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 deri 20 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, nuk zbatohet asnjë sanksion, vetëm për rastet kur ajo plotëson edhe kriteret financiare që caktohen nga Këshilli i Ministrave, përndryshe atyre nuk u lind e drejta e rritjes së pagës mesatare.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 20 për qind mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave, edhe kur plotësohen kriteret financiare, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit, baras me 500 për qind të kësaj rritjeje.

Për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore, veprimtaria e të cilave është me humbje, Këshilli i Ministrave cakton rregulla të veçanta për kufizimin e pagave.

Ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore janë të detyruara të paraqesin përkatësisht, sipas vartësisë, në ministri e institucion qendror, në rreth, bashki dhe komunë deklaratën, e cila përmban pagën mesatare mujore të caktuar nga ministria dhe pagën mesatare mujore e tremujore ose progresive për efekt kontrolli, duke mbajtur parasysh veçoritë e prodhimit.

Deklarata plotësohet sipas modelit që përcaktohet nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe paraqitet brenda datës 20 të muajit pasardhës, kurse derdhjet në buxhet bëhen brenda datës 25, në varësi të periudhës së kontrollit".

Neni 2

Shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

"Quhen shkelje të ligjit fshehja dhe falsifikimi i të dhënave të deklaratës, mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës, mosrespektimi i afateve të derdhjes në buxhet që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji.

Shkeljet e mësipërme dënohen me këto masa administrative:

- fshehja dhe falsifikimi i të dhënave të deklaratës me gjobë në masën 5-fish të shumës së fshehur ose të falsifikuar;

- mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë dhe paguhet nga drejtori i ndërmarrjes ose i institucionit jobuxhetor;

- mosrespektimi i afateve të derdhjes në buxhet me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë dhe paguhet nga kryetari i degës që mbulon pagat dhe drejtori i ndërmarrjes ose i institucionit jobuxhetor".

Neni 3

Shtohet neni 8/b me këtë përmbajtje:

"Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e caktuar për të ndjekur problemet e pagave përkatësisht në ministri, rreth, bashki e komunë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose njoftimit të tij, përkatësisht te titullari në ministri, në rreth, bashki dhe komunë, akti i të cilëve është i formës së prerë".

Neni 4

Neni 9 zëvendosohet me këtë përmbajtje:

"Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 për qind pa plotësuar kriteret që përcakton Këshilli i Ministrave, si dhe kur përsëriten shkeljet e detyrimeve të përmendura në nenin 2 të këtij ligji, përveç sanksioneve të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji, merren masa deri edhe në shkarkimin e drejtorit e të anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjes, institucionit shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.526, datë 28.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.